

LIGJ
Nr.8398, datë 3.9.1998

**PËR KOMPENSIMIN E ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE, JOBUJQËSORE DHE
TË TROJEVE TË ZËNA, QË NDODHEN NË ZONËN E LAPRAKËS DHE TË BATHORES
NË RRETHIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Të kompensohen në natyrë ish-pronarët ose trashëgimtarët ligjorë për pronat në formë kullote, livadhi, toke pyjore apo toke bujqësore dhe jobujqësore, që ndodhen në zonën e Laprakës dhe të Bathores, sipas përcaktimit në nenin 3 të këtij ligji, në rrethin e Tiranës dhe të patrajtuara nga ligji nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", në pronësi të shtetit, kur këto prona do të tjetërsohen në truall, duke u përfshirë brenda vijave kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara.

Neni 2

Ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre ligjorë të pronave, të treguara në nenin 1 të këtij ligji, të cilëve nuk u është kthyer prona, të kompensohen me troje në zonat turistike apo në qendrat e banuara, deri në masën 10 000 m².

Ish-pronarët ose trashëgimtarët ligjorë të trojeve të zëna, që ndodhen në zonat e treguara në nenin 1 të këtij ligji, të cilët nuk janë kompensuar, të kompensohen me troje në zonat turistike apo në qendrat e banuara, deri në masën 10 000 m².

Kur ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre ligjorë përfitojnë, sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, masa e kthimit, për secilin rast, do të jetë deri në masën 10 000 m².

Neni 3

Vendndodhja dhe shtrirja e sipërfaqes së zonave të treguara në nenin 1, mbi të cilat ky ligj sjell pasoja juridike, do të përcaktohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, me miratimin e studimit përkatës urbanistik.

Neni 4

Kompensimi sipas këtij ligji i pronave të ish-pronarëve do të fillojë pas miratimit të studimit përkatës urbanistik për zonat e treguara në nenin 3 të këtij ligji.

E drejta, masa, përparësitë, radha dhe kushtet e tjera të kompensimit të ish-pronarëve janë ato të parashikuara në ligjin nr.8084, datë 7.3.1996.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2209, datë 9.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani